



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtër për politika publike nr.30/2021


-

Cilësia e debatit në Kuvend- vështrim i shkurtër i cilësisë së debatit për periudhën 2020 - 2021

Autor: Zdravko Stavrov

-

shtator 2021



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

I. Hyrje

Cilësia e debatit në Kuvend, analizohet me përdorimin e "Indeksit për cilësinë e debatit", i zhvilluar nga Instituti për Demokraci bazuar në punën e profesorëve Marko R. Stenbergen, Andre Bahtiger, Markus Spärdli dhe Jung Shtajner, në studimin "Matja e diskutimit politik: Indeks për cilësinë e debatit".¹ Indeksi është instrument që lejon secilin akt individual të fjalimit në sesionin e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore: shkallës së argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në secilin diskutim); shkallën e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumentet e tyre; hapja për të pranuar argumentet e të tjerëve dhe ndryshim të qëndrimeve personale për shkak të argumenteve më të mira të paraqitura në debat; nëse deputetët mund të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre.

Nga janari 2018, vendoset një mënyrë e re e vlerësimit të cilësisë së debatit. Raportet gjashtëmujore nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend, përfshijnë vlerësimin e përgjithshëm në shkallën nga 1 - më e ulët në 10 - më e larta për cilësinë e debatit sipas indeksit të cilësisë së debatit. Një (1), si nota më e ulët do të thotë se deputetët nuk përdorin asnjë argument gjatë fjalimeve të tyre, nuk u referohen parimeve

të caktuara, i shtrembërojnë argumentet, nuk ndryshojnë pozicionin e tyre dhe nuk pranojnë argumente, nuk kanë referencë ndaj argumenteve të të tjerëve ose kanë ndryshim të qëndrimit, por jo për shkak të argumenteve të tjetrit. Nota një (1) gjithashtu do të thotë që deputetët tregojnë mosrespektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë dhe argumenteve të tyre (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), se ka ndërprerje të diskutimit dhe se në një moment ka pasur ndërprerje fizike të folësve.

Nga ana tjetër, nota dhjetë (10), që do të thotë se cilësia e debatit është e shkëlqyeshme, do të thotë që deputetët përdorin më shumë se dy argumente, ose të paktën një argument gjatë fjalimeve të tyre, i referohen parimeve të caktuara, adresojnë argumentet në përputhje me rrethanat, ka ndryshim të qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira, tregojnë respekt për personin dhe argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në diskutim (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), nuk ka ndërprerje të diskutimit dhe nuk ka asnjë kufizim të së drejtës për fjalë.

¹ Steenbergen, M.R., Bächtiger, A., Spärdli, M., Steiner, J., 2003. Measuring Political Deliberation: A Discourse Quality Index. *Comp. Eur. Polit.* 1, 21–48. <https://doi.org/10.1057/palgrave.cep.6110002>

II. Cilësia e debatit në Kuvend

Raporti i Institutit për Demokraci për periudhën nga janari deri në qershor 2021² tregon një nivel relativisht të ulët të cilësisë së debatit në Kuvend në dy vitet e fundit dhe konfirmon konkluzionin se ka vend për përmirësim të konsiderueshëm. Në shkallën nga 1 më e ulëta në 10 më e larta,

rezultati mesatar i cilësisë së debatit në Kuvend në gjysmën e parë të vitit 2021 është 5.6, i cili krahasuar me periudhën e mëparshme të monitorimit, ku nota mesatare ishte 5.5, tregon një përmirësim të vogël të nivelit të argumentimit (gusht - dhjetor 2020).³

Tabela 1. Vlerësimi i cilësisë së debatit për vitin 2020 dhe 2021 në një shkallë nga 1-më e ulët në 10-më e lartë

2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
5.5	5.6

III. Shkalla e arsytimit

Në lidhje me argumentimin e diskutimeve, përgjithësisht ka një përmirësim në nivelin e argumentimit nga pjesëmarrësit në diskutimin në Kuvend, krahasuar me periudhën e mëparshme të monitorimit (gusht - dhjetor 2020). Ndryshim pozitiv vërehet gjithashtu në përdorimin e një ose më shumë argumenteve në periudhën e monitoruar.

Raporti për cilësinë e debatit gjithashtu mat edhe shkallën e arsytimit, i cili përcakton nivelin e argumentimit të folësve gjatë fjalimeve të tyre. Në

periudhën janar - qershor 2021 në 38% të fjalimeve, folësit nuk kishin argumente, ndërsa argumentim i dobët u vërejt në 48% të fjalimeve. Vetëm në 14% të fjalimeve të tyre folësit kishin një ose më shumë argumente.

Në periudhën gusht - dhjetor 2020, folësit nuk përdorën argumente në 44% të fjalimeve të tyre, gjë që tregon përmirësim të vogël në periudhën janar - qershor 2021 (38%). Por, nga ana tjetër, vërehet rritje e vogël e argumentimit të dobët, me faktin se ndërsa në gusht-dhjetor 2020, 45% e

² Parliament Watch: Monitoring report on the debate quality in the Parliament (January-June 2021), accessed at: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/08/A4_Kvalitet_na_debata_januari_juni_2021MKD.pdf (last visited on: September 19, 2021)

³ Parliament Watch: Monitoring report on the debate quality in the Parliament (August-December 2020), accessed at: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/A4_Kvalitet_na_debata_avgust_dekemvri_2020MKD-3.pdf (last visited on: September 19, 2020)

diskutimeve u argumentuan dobët, në periudhën janar-qershor 2021, folësit argumentuan dobët në 48% të fjalimeve të tyre. Një ndryshim i lehtë pozitiv vërehet gjithashtu në përdorimin e një ose më shumë argumenteve. Në periudhën

gusht - dhjetor 2020, folësit përdorën një ose më shumë argumente në 11% të diskutimeve të tyre, ndërsa në periudhën janar - qershor 2021, një ose më shumë argumente u përdorën në 14% të diskutimit.

Tabela 2. Shkalla e argumentimit të deputetëve (%)

Argumentimi	2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
Nuk kanë argumente	44%	38%
Argumentojnë dobët	45%	48%
Një ose më shumë argumente	11%	14%

IV. Pjesëmarrja e deputeteve në diskutim

Në raportin për periudhën janar - qershor 2021, u vërejt një pjesëmarrje më e madhe e deputeteve në diskutimin parlamentar, krahasuar me periudhën (gusht - dhjetor 2020). Në këtë periudhë, në listën e 10 deputetëve më aktive bëjnë pjesë katër deputete, Gordana Siljanovska Davkova, Blagica Lasovska, Eli Panova dhe Snezhana Kaleska Vançeva. Nga ana tjetër, në raportin për periudhën gusht - dhjetor 2020, në 10 deputetët më aktivë bëjnë pjesë 3 deputete,

Gordana Siljanovska Davkova, Dafina Stojanovska dhe Zhaklina Llazarevska.

Në krahasimin e raporteve gjithashtu vërehet një rritje e pjesëmarrjes së deputeteve me 8%. Ndërsa në periudhën gusht - dhjetor 2020 pjesëmarrja e grave në diskutim ishte 35%, në raportin janar - qershor 2021 ato morën pjesë në 43% të diskutimeve.

Tabela 3. Pjesëmarrja e grave në diskutimin parlamentar (%)

2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
35%	43%

V. Fuqia e argumentit më të mirë

Në diskutimet që u monitoruan, në periudhën janar - qershor 2021, nuk u vërejt ndryshim në qëndrimin e deputetëve, as për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesit, as për arsye të tjera. Ndërsa në periudhën gusht - dhjetor 2020 deputetët në 54% të diskutimeve të tyre nuk iu referuan fuqisë dhe cilësisë së argumenteve të folësve të tjerë, në periudhën janar - qershor 2021 ky është rasti në 46% të diskutimeve. Ky reduktim i injorimit të argumenteve të të tjerëve tregon ndërveprim

më të madh ndërmjet deputetëve. Megjithatë, deputetët mbajtën qëndrimin e tyre dhe nuk e pranuan vlerën e argumenteve të kolegëve nga partitë e tjera politike. Në periudhën janar - qershor 2021, deputetët e bënë këtë në 40% të diskutimeve, ndërsa në periudhën gusht - dhjetor 2020 kjo ndodhi në 37% të diskutimeve, që tregon përkeqësim të vogël në gjysmën e parë të vitit 2021.

Tabela 4. Fuqia e argumentit më të mirë (%)

Fuqia e argumentit më të mirë	2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
Deputetët nuk iu referuan fuqisë dhe cilësisë së argumenteve të folësve të tjerë	54%	46%
Deputetët ngelën në pozicionin e tyre dhe nuk e pranuan vlerën e argumenteve të kolegëve të opsjoneve të tjera politike	37%	40%

VI. Raporti ndaj argumenteve dhe ersonalitetit të deputetëve nga parti tjetër

Deputetët, në periudhën janar-qershor 2021, iu referuan më shumë shqyrtimit të personalitetit të bashkëbiseduesve sesa argumenteve të tyre. Në 12% të fjalimeve, deputetët shprehën respekt ose respekt të pjesshëm për argumentet e deputetëve nga partia tjetër politike, ndërsa në periudhën gusht - dhjetor 2020 kjo ndodhi në 16% të diskutimeve, që do të thotë 4% rënie ose regres në atmosferën e përgjithshme korrekte, për diskutim në Kuvend. Nga ana tjetër, në periudhën janar - qershor 2021, deputetët shprehën mosrespektim

ose mosrespektim të pjesshëm ndaj argumenteve në 15% të diskutimeve, ndërsa në periudhën gusht - dhjetor 2020 kjo përqindje është 26%, përkatësisht në periudhën janar - qershor 2021, vërehet përparim për 11%. Megjithatë, zvogëlimi i mosrespektimit të argumenteve të deputetëve të tjerë nuk do të thotë domosdoshmërisht përmirësim të nivelit të respektit në Kuvend, sepse kjo shkon në llogari të injorimit të argumenteve dhe adresimit të personalitetit të deputetëve.

Tabela 5. Raporti ndaj argumenteve të deputetëve të partisë tjetër (%)

Raporti ndaj argumenteve të deputetëve të partisë tjetër	2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
Respekt ose respekt i pjesshëm	16%	12%
Mosrespektimi ose mosrespektimi i pjesshëm	26%	15%

Në raportin ndaj personalitetit të deputetëve nga një parti tjetër, vërehet një trend më ndryshe. Në vitin 2020 respekti ose respekti i pjesshëm ishte 29% ndërsa në vitin 2021 kjo përqindje është 32% që paraqet përmirësim të dukshëm. Nga ana

tjetër, ekziston një trend negativ, me mosrespektimin ose mosrespektimin e pjesshëm të personalitetit të deputetëve nga një parti tjetër, i cili në vitin 2020 ishte 9%, në vitin 2021 u rrit në mënyrë dramatike dhe arriti në 20%.

Tabela 6. Raporti ndaj personalitetit të deputetëve nga parti tjetër (%)

Raporti ndaj personalitetit të deputetëve të partie tjetër	2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
Respekt ose respekt i pjesshëm	29%	32%
Mosrespektimi ose mosrespektimi i pjesshëm	9%	20%

VII. Grupet e margjinalizuara në Kuvend

Raporti për periudhën janar - qershor 2021 konfirmon referencën e ulët të vazhdueshme të deputetëve për të drejtat e grupeve të margjinalizuara, që vërehet gjatë të gjitha periudhave të monitorimit. Këtë periudhë deputetët në rreth 89% të diskutimeve të tyre, nuk kanë folur në lidhje me të drejtat e grupeve të margjinalizuara,

përveç nëse diskutohet specifikisht ligj ose temë e caktuar, në rendin e ditës në lidhje me të drejtat e tyre. Megjithatë, krahasuar me periudhën e mëparshme (gusht - dhjetor 2020), kur folësit nuk u janë referuar grupeve të margjinalizuara në mbi 93% të fjalimeve, vërehet përmirësim i vogël në këtë fushë.

Tabela 7. Përfaqësimi i grupeve të margjinalizuara në Kuvend(%)

Grupet e margjinalizuara në Kuvend	
2020 (gusht - dhjetor)	2021 (janar - qershor)
93%	89%

VIII. Rekomandime

Bazuar në të dhënat e paraqitura më lart në këtë analizë të shkurtër, por edhe punën shumëvjeçare të Institutit për Demokraci (IDSCS) në monitorimin e punës së Kuvendit, në vazhdim janë dhënë disa rekomandime që mund të zbatohen për të përmirësuar cilësinë e debatit:

-Rritja e informimit dhe njohurive mbi temat që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësim i aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve mund të kontribuojnë ndjeshëm për debat më të cilësor në Kuvend

-Kuvendi duhet të përfshihet në procesin e vlerësimit të ndikimit të rregullativës (VNR), përmes së cilit do të rritet ndjeshëm cilësia dhe argumentimi i diskutimeve

-Deputetët duhet të përdorin me kujdes dhe në mënyrë minimale procedurën e shkurtuar dhe procedurën për shqyrtimin e propozim - ligjeve me flamurin Evropian

-Është thelbësore që deputetët të mbi ndërtohen me profesionalizëm dhe të kuptojnë për ndikimin e ligjeve mbi jetën e grupeve të ndryshme të qytetarëve

-Rritja e informimit dhe njohurive mbi temat që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësim i aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve mund të kontribuojnë ndjeshëm për debat më të cilësor në Kuvend Instituti Parlamentar (IP) dhe Zyra Parlamentare për Buxhet (ZPB), të cilat funksionojnë në suazat e Kuvendit, ofrojnë shërbime që mund të adresojnë këto nevoja të deputetëve. Gjegjësisht, IP dhe ZPB, kryejnë punë kërkimore mbi tema me interes për deputetët, si dhe edukim dhe trajnim në fusha të veçanta. Së këndejmi, paraqitet nevoja për përdorim më efikas dhe më efektiv të shërbimeve të IP-së dhe ZPB-së, nga deputetët.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtër për politika publike nr.30/2021

**Cilësia e debatit në Kuvend- vështrim
i shkurtër i cilësisë së debatit për
periudhën 2020 - 2021**

Autor: Zdravko Stavrov

shtator 2021